



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 15 korrik 2013
Nr.ref.:RK452/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI63/13

Parashtrues

Safet Voca

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
kërkesës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme drejtuar ankuesve
për të siguruar përkthimin e të gjitha dokumenteve në gjuhën angleze**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Safet Voca, kryetar i Degës së Odës së Avokatëve në Mitrovicë. Parashtruesi përfaqësohet nga Kapllan Baruti, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Përfaqësuesi e konteston kërkesën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ankuesit në Dhomën e Posaçme duhet të sigurojnë përkthimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve në lidhje me ankesën e tyre, bazuar në Ligjin nr. 04/L-033, për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për Dhomën e Posaçme). Kjo kërkesë është specifikuar në nenin 25 (8) të Rregullores së punës së Dhomës së Posaçme, në Shtojcën e Ligjit për Dhomën së Posaçme.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se kërkesa për të dorëzuar përkthimet e të gjitha dokumenteve në gjuhën angleze përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Parashtruesi i referohet nenit 5 (1) për Gjuhët zyrtare të Kosovës, nenit 16 (1) dhe (4) për Epërsinë e Kushtetutës, dhe pretendimet që kërkesa bën diskriminim në bazë të gjuhës duke e shkelur nenin 24 (2) të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 28, 29 dhe 30 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 prill 2013, parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 29 prill 2013, Kryetari me Vendimin Nr. KSH. KI63/13, e caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi Gjyqtare raportuese si dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 13 maj 2013, Gjykata Kushtetuese e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë kërkesën zyrtare të plotësuar në formularin e duhur së bashku me kopjet e të gjitha vendimeve relevante të autoriteteve publike.
8. Më 16 maj 2013, parashtruesi e dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës.
9. Më 17 qershor 2013, Kryetari e caktoi gjyqtarin Robert Carolan, Gjyqtar raportues në zëvendësim të gjyqtares Arta Rama-Hajrizi.
10. Më 20 qershor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandim për papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit

11. Më 23 prill 2013, parashtruesi i dërgoi një letër Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme ndaj ankuesve për të dorëzuar përkthimet në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve dhe vendimeve në lidhje me ankesat e tyre.
12. Nuk duket se parashtruesi ka qenë palë në ndonjë procedurë ligjore apo se ka iniciuar ndonjë procedurë ligjore ose procedurë tjetër në lidhje me këtë kërkesë.
13. Neni 25 (8) i Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

"Lutjet dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten ose në gjuhën shqipe, ose në gjuhën serbe dhe duhet të shoqërohen nga një përkthim në gjuhën angleze, shpenzimet e përkthimit i heq pala që dorëzon atë lutje dhe ato dokumente".

Argumentet juridike të paraqitura nga parashtruesi

14. Parashtruesi pretendon se dispozita e nenit 25 (8) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, që kërkon nga ankuesit të dorëzojnë përkthimin e të gjitha dokumenteve dhe vendimeve të tyre në gjuhën angleze në lidhje me ankesën e tyre është në kundërshtim me përcaktimin kushtetues të gjuhëve zyrtare në Kosovë.
15. Për më tepër, parashtruesi argumenton se, *"Sipas dispozitës së nenit 5 paragrafi 1 të Kushtetutës, gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Neni 16 paragrafi 1 parasheh se ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë kushtetutë, ndërsa paragrafi 4 i po të njëjtës dispozitë thotë se secili person dhe organ i Republikës së Kosovës iu nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës".*
16. Parashtruesi thekson se neni 102 (3) i Kushtetutës parasheh se *"Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit".*
17. Për më tepër, neni 2 (1) i Ligjit për përdorimin e gjuhëve (Ligji Nr. 02/L-37) parasheh se, *"Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës,"* dhe neni 2 (2) thotë se, *"Të gjithë personat kanë të drejta të barabarta në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet e Kosovës".*
18. Përfundimisht, neni 12 (1) i Ligjit për përdorimin e gjuhëve specifikon se, *"Gjuhët zyrtare përdoren në mënyrë të barabartë në procedurat gjyqësore".*
19. Parashtruesi gjithashtu pretendon se kërkesa për të siguruar përkthimin e dokumenteve në gjuhën angleze gjithashtu paraqet diskriminim në bazë të gjuhës ndaj të gjithë qytetarëve të Kosovës, kur ushtrojnë ankesa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, në kundërshtim me nenin 24 (2) të Kushtetutës.
20. Parashtruesi tregon në kërkesën e tij se argumentet dhe vërejtjet e tij janë të natyrës dhe të karakterit të përgjithshëm, dhe se ai nuk thirret në ndonjë rast të veçantë ose në një sërë procedurash të veçanta.

21. Parashtruesi gjithashtu kërkon që në bazë të nenit 116 (2) të Kushtetutës, Gjykata të urdhërojë suspendimin e përkohshëm të kërkesës për sigurimin e përkthimeve të gjuhës angleze, siç parashihet me nenin 25 (8) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, derisa të merret vendimi përfundimtar i Gjykatës në lidhje me kërkesën.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Së pari, për të qenë në gjendje të vlerësojë kërkesën e parashtruesve, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
23. Gjykata duhet në mënyrë specifike të përcaktojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kërkesat e nenit 113 (1) të Kushtetutës dhe nenit 47 (1) të Ligjit dhe të rregullit 36 (2) (c) të Rregullores së punës.
24. Gjykata i referohet nenit 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Neni 47 (1) i Ligjit parasheh se:

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

26. Për më tepër, rregulli 36 (3) (c) i Rregullores së punës përcakton se:

“(3) Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

[...]

c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar”.

27. Gjykata vëren se parashtruesi thekson se ai nuk i referohet ndonjë rasti apo një sërë procedurash, por se komentet dhe argumentet e tij janë të natyrës dhe të karakterit të përgjithshëm.

28. Gjykata më tutje vëren se parashtruesi nuk siguron informata në lidhje me ndonjë procedurë ose veprim ligjor në lidhje me ankesat e tij.
29. Sa i përket të drejtës të parashtruesit për të parashtruar kërkesë sipas nenit 113 (7) të Kushtetutës, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk artikulon ndonjë të drejtë apo dhe liri individuale që mund të jetë shkelur dhe as që i referohet ndonjë veprimi apo vendimi konkret të një autoriteti publik që mund të ketë cenuar të drejtat e tij themelore.
30. Në esencë, Gjykata konsideron se parashtruesi është duke kërkuar një mendim këshillëdhënës apo një shqyrtim abstrakt të kushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 25 (8) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme.
31. Në këto rrethana, Gjykata gjen se parashtruesi, në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës në lidhje me rregullin 36 (3) (c) të Rregullores së punës, nuk është palë e autorizuar për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së një dispozite ligjore.
32. Prandaj, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës po ashtu nuk është palë e autorizuar për të kërkuar pezullimin e përkohshëm të zbatimit të nenit 25 (8) të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme. Për këtë arsye, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme sipas nenit 116 (2) të Kushtetutës duhet të refuzohet.
33. Në përfundim, Gjykata gjen se kërkesa nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore nga një palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113 (1) të Kushtetutës dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar.
34. Rrjedhimisht, për arsyet e cekura më lart, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113 (1) të Kushtetutës, neneve 46 dhe 47 (1) të Ligjit dhe rregullit 36 (3) (c) të Rregullores së punës, më 15 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe,
- V. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani